



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2023:072660

Datë: 12.03.2025

Numri i dokumentit: 06980052

C.nr.433/2023

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, me gjyqtarin Skender Shala, në çështjen juridike kontestimore të paditësit F.S. nga Mitrovica, kundër të paditurës KM , me objekt kontesti “*Kompenzim i të ardhurave nga marrëdhënia e punës*”, jashtë seance, me dt. 12.03.2025, bie këtë:

A K T V E N D I M

HUDHET si e palejuar padia e paditësit F.S. nga Mitrovica e ushtruar kundër të paditurës KM, për kompenzimin e të ardhurave nga marrëdhënia e punës, nga fakti se kjo çështje është çështje e gjykuar.

A r s y e t i m

Paditësja ka ushtruar padi kundër të paditurës, për kompenzimin e shujtave të ushqimit. Gjykata, pas shqyrtimit të padisë, shkresave tjera të lëndës dhe gjenerimit të të dhënave nga sistemi SMIL, gjeti se për çështjen e paditësit ekziston gjyqëvarsia (Litispendenca) ngase për të njejtën çështje dhe në mes të të njejtave palë ndërgjyqëse në këtë gjykatë është zhvilluar procedura kontestimore gjë e cila vërtetohet në bazë të Aktgjykimit C.nr.967/2024 të datës 03.12.2024, vlerëson se kjo çështje konsiderohet si çështje e gjykuar (res iudicata), në kuptim të nenit 391 (d) të LPK-së.

Andaj, nga arsyet e cekura më lartë, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil

C.nr.433/2023, datë. 12.03.2025.

Gj y q t a r i ,
Skender Shala

KESHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh , nga dita e pranimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e përmes kësaj gjykate.